

DREJTORIA E RAJONIT VERIOR SHKODER
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 07.01.2019

Për: **“ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCION” sh.p.k**, me numer NIPTI **K 91326028 I**, perfaqesues ligjor Z.Arber Abazi, me adrese: Rr. “ *Reshit Petrela*”, Kompleksi Usluga kati i 8, Tirane.

Procedura e prokurimit: *Procedure e Hapur*

Numri i referencës së procedurës/lotit : **REF-73463-06-05-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Kuben – Vasie 35.4 km”**.

Me fond limit: **44 534 152** (dyzet e kater milion e pesëqind e tridhjetë e kater mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) **leke pa tvsh/** Buxheti i Shtetit. Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 11.06.2018] [Numri 23]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Në këtë procedure prokurimi moren pjesë **6 (gjashtë) ofertues**, operatorë ekonomik, përkatësisht:

- 1. B.O “ DODA NDERTIM” shpk**, përfaqësues ligjor Z. Ramazan Doda, NIPT **J 97005705 B** me adrese: *Tomin Pilafe, Ndertesa 3- kateshe, ne vendin e quajtur “Kuben”,* kuote përfaqësimi **51% & “EURALDI” sh.p.k**, me numer NIPTI **J 66702706 K**, perfaqesues ligjor Z.Illir Bulku, me adrese: *Diber, Melan,* kuotë përfaqësimi **49 %** , me oferte: 43 373 053 (*dyzet e tre milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e tre*) **leke pa tvsh dhe: 52 047 664** (*pesëdhjetë e dy milion e e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e kater*) **leke me tvsh.**
- 2. “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCCION” sh.p.k**, me numer NIPTI **K 91326028 I**, perfaqesues ligjor Z.Arber Abazi, me adrese: *Rr. “ Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga kati i 8, Tirane,* me oferte: 40 450 292 (*dyzet milion e katerqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy*) **leke pa tvsh dhe: 48 540 350** (*dyzet e tetë milion e pesëqind dyzet mijë e treqind e pesëdhjetë*) **leke me tvsh.**
- 3. “ CURRI” shpk**, përfaqësues ligjor Z. Faik Curri, NIPT **J 67902718 S** me adrese: *Rr. “Kajo Karafili”, Pallati Bimbashi 8/2, Shk.2, Kati II, Ap. 2 Tirane,* me oferte: 30 220 926 (*tridhjetë milion e dyqind e njëzet mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë*) **leke pa tvsh dhe: 36 265 111** (*tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë*) **leke me tvsh.**
- 4. “ALB SHPRESA” sh.p.k**, me numer NIPTI **J 72110003 F**, perfaqesues ligjor Z.Mehdi Lala, me adrese: *Rr. “ Maliq Muço”, Nd. 6, Hyrja 4 , Ap. 14, Tirane,* me oferte: 39 000 000 (*tridhjetë e nëntë milion)* **leke pa tvsh, 46 800 000** (*dyzet e gjashtë milion e tetëqind mijë)* **leke me tvsh.**
- 5. “SELAMI” sh.p.k** me perfaqesues ligjor z.Musa SELAMI, me adrese: *Peshkopi, Lgj. “Nazmi Rushiti”, Rr. “Tercilio Kardinali”,* me numer NIPTI **J 77304706 L**, me oferte: 37 852 747 (*tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e shtatë*) **leke pa tvsh, 45 423 297** (*dyzet e pesë milion e katerqind e njëzet e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë*) **leke me tvsh;**

6. Person fizik Z.Adem Pojani

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Adem Pojani

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nuk plotëson asnjë nga kriteret e kualifikim pasi nuk është ngarkuar asnjë dokument ligjor në sistem.

2. “SELAMI” sh.p.k

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

Njoftojme s'kualifikimin tuaj nga kjo procedure per keto arsye: per sa ju perket mjeteve Borepastruese dhe Kamiona, pasi rezultojne te njejta me mjetet borepastruese te perdorura ne prokurimin me objekt "*Mirembajtje Rutine dhe Dimerore me Performance Rruga Peshkopi- Qafe Draj*", ne te cilin jeni kualifikuar dhe renditur i pari, prandaj mjetet tuaja rezultojne te angazhuara ne tjetër objekt, ne kundërshtim me ate qe eshte percaktuar ne kriteret per kualifikim.

3. “CURRI” shpk

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nuk plotësoni kushtet per kualifikim per sa ju perket mjeteve te punes pasi per mjetin “autobetoniere” keni paraqitur dokumentacion qe i perket mjetit te punes “kamion”.

Si rrjedhim nuk plotësoni kriterin 2.3.7,i cili percakton ;”Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates.Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe makinerite qe ka ne dispozicionapo mund ti vihen ne dispozicionoperatorit ekonomik’.E shoqeruar pastaj,me leje qarkullimi,certifikat e kontrollit teknik ,foto,etj.

Ne kundërshtim edhe me percaktimet e nenit 46/b i LPP-se ku thuhet se per te provuar aftesine teknike operatorët ekonomik vertetojne se :zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike,profesionale,kapacitetet organizative ,makinerite,pajisjet e asete te tjera fizike,aftesite organizative,reputacionin dhe besueshmerine,pervojen e duhur,si dhe personelin e nevojshem,per te zbatuar kontraten,sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.

4. B.O“DODA NDERTIM” sh.p.k& “EURALDI” sh.p.k

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Bilancet e shoqerise "Doda Ndertim" shpk per vitet 2016-2017, jane te pakonfirmuar nga ekspertet kontabel;

2. Kontrata e bashkepunimit ka gabim objektin e prokurimit per te cilin eshte lidhur;

3. Kontrata per punime te ngjashme tejkalon afatin 3 vjecar pasi lidhja eshte bere me date 30.06.2015, dhe llogaritja e afatit fillon nga data e tenderit dhe jo nga data e nenshkrimimit te kontrates;

4. Shoqeria "Euraldi" shpk nuk ka paraqitur certifikata ISO, sic percaktohet ne kriteret e kualifikimit.

5. ”ALB-SHPRESA”Shpk

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

1.Vërtetimi per shlyerjen e detyrimeve te maturuara të energjisë elektrike me nr.4761 prot, dt.05.06.2018 leshuar ne emer të kërkuesit “ Alb Shpresa” sh.p.k, shpreh se kontrata me kod TR1C110081111106 eshte ne emer te “ Curri” sh.p.k, në kundërshtim me piken 2 **Kriteret e vecanta te Kualifikimit**, pika 1 germa “d” që përcakton detyrimin per paraqitjen e nje: “Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.

Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Referuar vertetimit të debise nr 4761, dt. 05.06.2018 rezulton se operatori “ Alb Shpresa “ sh.p.k është thjesht përdorues i kësaj kontrate qeraje dhe kjo bëhet zakonisht për të shmangur tarifimin e ndryshëm që i bëhet kontratave të energjisë elektrike të biznesit të cilat kanë një tarifim më të lartë krahasuar me kontratat për abonentët familjarë. Kontrata për furnizim me energji elektrike është një kontratë që lidhet midis OSHEE dhe konsumatorit të energjisë elektrike. Duke pasur parasysh përmbajtjen e këtyre kontratave tip në asnjë nen të kontratës nuk thuhet që shërbimi që ofrohet nga kjo kontratë mund të kalojë me anë të një kontrate tjetër përdorimi apo cfardolloj kontrate. Gjithashtu theksojmë se para të tretëve apo para dhe vetë OSHEE për këtë kontratë dhe për shërbimin e ofruar përgjigjet vetëm personi që ka në pronësi kontratën e furnizimit dhe jo personi që e ka në përdorim këtë kontratë. Në vërtetimin e energjisë elektrike të paraqitur nga ana juaj, madje nuk cilësohet qartë as si përdorues dhe as si titullar i kësaj kontrate, në kundërshtim me VKM-ne.

2.Mjeti i punes “ Autobetoniere” , marrë me qera nga “ Mela” sh.p.k per llogari te “Alb shpresa” sh.p.k, është i njëjti mjet i paraqitur nga B.O.E “ EKSLUZIV” sh.p.k, & “MELA.” shpk, te shpallur fitues dhe finalizuar me kontrate ne objektin: Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "U.Matit -Rrëshen (Ura e Fanit), Rrëshen (U.Fanit)- Shpal, Shpal- Q.Benë- K.Hadroj, Shpal- Ura e Repsit 84.9 km " .

Fakt ky , që vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 46/ b) i LPP-së ku thuhet se për të provuar aftësinë teknike: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se: zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën*, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës si dhe me piken 2.3.8 e DST – ve përcakton: *“Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera per te gjithe periudhen e percaktuar si afati i kryerjes se sherbimit*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik ekonomik **“ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCCION” sh.p.k**, me numer NIPTI K 91326028 I, perfaqesues ligjor Z.Arber Abazi, me adrese: Rr. “ Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga kati i 8, Tirane, me oferte: 40 450 292 (dyzet milion e katerqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) **leke pa tvsh dhe: 48 540 350 (dyzet e tetë milion e pesëqind dyzet mijë e treqind e pesëdhjetë) leke me tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise Rajonit Verior Shkoder, me adrese; Rr. At Zef Valentini, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do te procedohet ne zbatim te legjislacionit te prokurimeve publike, i ndryshuar.

Njoftimi i Riklasifikimit është bërë në datë **26.11.2018**

Ankesa: **Po.**

Faza e vlerësimit dhe e klasifikimit të ofertave, përfundoi me datë 25/07/2018 pasi iu dha edhe konfirmimi në sistem nga personi i autorizuar i Njesisë së Prokurimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas mbylljes së fazes së vlerësimit, la në dispozicion të ofertuesve afatin 7 (shtatë) ditor për paraqitjen e ankesave në lidhje me vlerësimin.

Brenda afati ligjor 7 ditor u paraqiten ankesat si me poshte vijon:

Ne datën 31.07.2018 ka paraqitur pranë AK formularin e ankesës sipas shtojcës së përcaktuar në DST, subjekti Operatori ekonomik.

1. **“CURRI” sh.p.k**, regjistruar nga AK me nr prot 310 dt.31.07.2018 me objekt: **“Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Kuben – Vasie 35.4 km”**.

Në lidhje me ankesat e këtij subjekti Drejtoria e Rajonit Verior Shkoder, ka dalë me vendimin e datës 06.08.2018, i cili është përcjellë subjektit ankimues me shkresën nr.324 prot, datë 06.08.2018, sipas këtij vendimi ankesa e këtij subjekti nuk është pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave duke i qendruar vlerësimin që ka bërë KVO.

Me datë 17.08.2018 jemi vënë në dijeni që subjekti ankimues “CURRI” sh.p.k, i është drejtuar KPP-se si organ epror për shqyrtimin e ankesës në themel.

Me depozitimin e ankesës së subjektit “CURRI” sh.p.k pranë KPP-së, ky i fundit doli me vendimin Nr.1404/1, datë 20.08.2018, protokolluar nga AK me Nr 352, dt.24.08.2018 për pezullimin e procedurës.

AK me shkresën Nr.45 prot, datë 24.08.2018 pezulloi procedurën.

Me shkresën Nr 360 prot, datë 28.08.2018, AK informon KPP-në mbi ecurinë e kësaj procedure.

KPP me vendimin **Nr.717/2018, përcjellë me shkresën nr 717/1 datë 23.10.2018**, protokolluar me tonen nr 343 dt. 25.10.2018, ndër të tjera vendosi:

1. Shfuqizimin e vendimit të KVO-se lidhur me s’kualifikimin e operatorit ekonomik **“CURRI” sh.p.k**, pranimin e ankesës së subjektit “CURRI” sh.p.k, anulimi i vendimit të KVO-se, rivlerësimi për këte objekt në favor të subjektit ankimues, informimin e KPP-se për zbatimin e këtij vendimi.

Me datë 31.10.2018 u krye në sistem Ri-vlerësimi në zbatim të vendimit të lartpërmendur të KPP-se.

AK me shkresën nr 444 prot, dt.01.11.2018 informon KPP-ne për zbatimin e vendimit, duke lënë në dispozicion të ofertuesve të drejtën e ankimimit, brenda afateve ligjore.

Pas këtij ri-vlerësimi, si rezultat i të cilit u rëndit i pari operator “CURRI”sh.p.k, brenda afatit ligjor 7 –ditor paraqiten ankesat:

1. **“Alko Impex General Constuction” sh.p.k**, me datë 05.11.2018, regjistruar me nr.451 prot.

Me shkresën nr 477, dt.12.11.2018 AK i bëri kërkesë për interpretim KPP-së, për efekt të interpretimit dhe vlerësimit të fakteve të reja dhe me qëllim mos zvarritjen në kohë të kësaj procedure.

KPP me shkresen nr 791, dt.21.11.2018, protokolluar nga AK me nr 497, dt.22.12.2018 i komunikon AK-së pergjigjen në lidhje me interpretimin e kërkuar duke theksuar faktin se AK gjendet në kushtet e aplikimit të nenit 63, të LPP-së, shqyrtimi i ankesave.

Nga sa më sipër,

AK me vendimin e dates 23.11.2018, vendos pranimin e ankeses së subjektit **Alko Impex General Constuction” sh.p.k**, percjelle me shkresen nr 505 prot, duke i celur rruge afateve të ankimimit rishtazi, si pasojë e **ri-vlerësimit të bërë në sistem dt. 26.11.2018** (i treti per nga radha) bazuar në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, per pranimin e ankeses së subjektit **Alko Impex General Constuction” sh.p.k**, i cili pas pranimit te ankeses dhe kualifikimit u rendit i pari.

Si rrjedhoje, brenda afatit 7 ditor per pararqitjen e ankesave, pranë AK-së ngriti ankesë

1. “ CURRI” sh.p.k, me nr 106 prot, dt.28.11.2018, protokolluar nga AK me nr 517, dt.03.12.2018.

AK i kthen pergjigje me shkresen Nr.528, dt.05.12.2018, duke rrëzuar ankesen e subjektit në fjalë me fakte konkrete.

Gjithashtu paraqiti ankese subjekti;

2. “ ALB SHPRESA “ sh.p.k, me nr 150, dt.03.12.2018, protokolluar nga AK me nr 516, dt.03.12.2018, i cili mori pergjigje nga AK me shkresen Nr.526, dt.05.12.2018, ku u vendos rrëzimi i ankeses duke e shoqëruar me fakte konkrete.

Subjekti “CURRI” sh.p.k, i drejtohet KPP-së me ankesë nr 113/2, dt.12.12.2018, protokolluar nga AK me nr 542, dt.13.12.2018.

KPP me vendimin Nr 1859/1, dt.17.12.2018, protokolluar nga AK me nr 561, dt.19.12.2018, vendosi pezullimin e procedures.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.1,date 04.01.2019, nder te tjera vendosi:

1. Te mos pranoje ankesene paraqitur nga operatori ekonomik “Curri”Shpk, per kete procedure prokurimi.
2. Autoriteti kontraktor lejohet te vijoj me hapat e metejshem te procedures se prokurimit.